



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.63

25 maj

2011

P Ë R M B A J T J A

| | | Faqe |
|---|---|------|
| Urdhër i METE nr.302, datë 12.4.2011 | Për miratimin e parimeve bazë për hartimin e planit të rehabilitimit të mjedisit, të planit të veprimtarive të mbylljes së veprimtarisë minerare, të mënyrës së përcaktimit të zonës së rrezikshme të një të drejte minerare dhe të planit të menaxhimit të mbetjeve minerare | 2555 |
| Urdhër i METE nr.304, datë 13.4.2011 | Për miratimin e formës dhe përmbajtjes së projektit të zhvillimit të veprimtarisë minerare..... | 2557 |
| Urdhër i METE nr.305, datë 13.4.2011 | Për procedurat dhe formën e hartimit të programit të veprimit për zbatimin e strategjisë minerare..... | 2587 |
| Urdhër i METE nr.306, datë 13.4.2011 | Për procedurat dhe formën e hartimit të planit vjetor minerar | 2589 |

URDHËR
Nr.302, datë 12.4.2011

PËR MIRATIMIN E PARIMEVE BAZË PËR HARTIMIN E PLANIT TË REHABILITIMIT TË MJEDISIT, TË PLANIT TË VEPRIMTARIVE TË MBYLLJES SË VEPRIMTARISË MINERARE, TË MËNYRËS SË PËRCAKTIMIT TË ZONËS SË RREZIKSHME TË NJË TË DREJTE MINERARE DHE TË PLANIT TË MENAXHIMIT TË MBETJEVE MINERARE

Në zbatim të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 37 pika 1 dhe nenit 56 pika 2 të ligjit nr.10 304, datë 15.7.2010 “Për sektorin mineral në Republikën e Shqipërisë”,

URDHËROJ:

1. Parimet bazë për hartimin e planit të rehabilitimit të mjedisit mbështeten në legjislaconin mineral dhe mjedisor në fuqi. Këto parime përfshijnë konceptet e:

a) Zhvillimit të qëndrueshëm të veprimtarive minerare në respekt të ambientit dhe të certifikuar nga komuniteti, duke mbrojtur pasuritë natyrore për të siguruar plotësimin e nevojave aktuale pa kompromentuar aftësinë e brezave të ardhshëm, për të plotësuar nevojat e tyre, si dhe duke bërë të mundur ruajtjen afatgjatë të cilësisë së mjedisit dhe diversitetit biologjik të tij.

b) Interesit publik për një veprimtari minerare ku vendimmarrja bëhet në kushtet e transparencës, paraprihet nga këshillimet me komunitetin e zonës dhe mendimin me shkrim të njëjësive përkatëse të qeverisjes vendore.

c) Dallimit dhe pavarësisë të së drejtës minerare nga e drejta e pronësisë mbi sipërfaqen e tokës, duke garantuar pronësinë e shtetit mbi mineralet dhe ruajtur pronësinë e sipërfaqes ku këto minerale gjenden, duke përcaktuar marrëdhënien ndërmjet këtyre të drejtave me marrëveshje, sipas legjislaconit në fuqi.

d) Marrjen e masave paraprake, për parandalimin, apo në rast se nuk është e mundur minimizimin e dukurive e efekteve negative në mjedis dhe garantimin e marrjes së masave efektive në kohë dhe me kosto më të ulët.

e) Ruajtjes së pasurive natyrore gjatë veprimtarive minerare që përfshin mbrojtjen, ruajtjen dhe përmirësimin e cilësisë së burimeve natyrore; ajrit, ujit, detit, tokës, pyjeve, biodiversitetit dhe diversitetit të peizazhit natyror.

f) Zëvendësimit dhe/ose kompensimit që nënkupton masat, që duhet të merren për të zëvendësuar çdo ndërhyrje që mund të sjellë efekte të dëmshme mbi mjedisin, për të siguruar përdorimin e praktikave më të mira, përdorimin e produkteve, pajisjeve dhe aparaturave, si dhe zbatimin e atyre proceseve të prodhimit, të cilat janë më pak të dëmshme apo të padëmshme për mjedisin.

g) Qasjes së integruar që garanton një zhvillim të balancuar ekonomik, parandalon rrezikun ndaj mjedisit dhe/ose reduktionin e rrezikut në tërësi, nëpërmjet planifikimit të territorit, duke i kushtuar një rëndësi të veçantë cënueshmërisë së mjedisit në vendin specifik, lidhjes ndërmjet ekuilibrit dhe vlerave të peizazhit natyror, lidhjes ndërmjet pasurive natyrore të ripërtërishme dhe jo të ripërtërishme, trashëgimisë kulturore dhe pasurive materiale, tërësisë së ndërveprimeve të tyre reciproke, si dhe ndërveprimin ndërmjet pasurive materiale ekzistuese dhe atyre të planifikuara.

h) Bashkëpunimit dhe veprimet e përbashkëta ndërmjet autoriteteve të qeverisjes qendrore dhe asaj vendore dhe sigurimit të këtij bashkëpunimi në rang rajonal dhe më gjerë, mbi bazën e marrëveshjeve ndërkufitare, ndërqeveritare dhe ndërkombëtare.

i) Ndotësi paguan për veprimet ose mosveprimet, të cilat rezultojnë në dëmtimin e mjedisit apo në rrezikun e dëmtimit të mjedisit duke vendosur përgjegjësitë financiare për të eliminuar këtë dëmtim. Kosto të tilla mund të përfshijnë kostot e vlerësimit të dëmtimit të mjedisit, vlerësimit të masave të nevojshme, si edhe kostot e menjanimin të dëmtimit të mjedisit, duke përfshirë edhe kostot e rehabilitimit dhe të kompensimit ose dëmtimit e shkaktuara ndaj të tretëve, nga zotëruesi i lejes minerare.

j) Aksesit ndaj informacionit dhe pjesëmarrjes së publikut, duke garantuar që çdo person ka të drejtë të marrë në kohë informacion mbi ndotjen e mjedisit, masat e marra për eliminimin e kësaj ndotje apo dëmtimi të mjedisit.

k) Promovimit të të gjitha atyre veprimtarive, të cilat parandalojnë apo reduktojnë ndotjen e mjedisit, si edhe projekteve, të cilat sjellin pakësimin e përdorimit të substancave, lëndëve të para dhe energjisë, apo të cilat e ndotin mjedisin në një masë më të vogël.

2. Parimet bazë për hartimin e planit të veprimtarive të mbylljes së veprimtarisë minerare mbështeten në legjislacionin minerar dhe mjedisor në fuqi. Këto parime përfshijnë konceptet e:

- a) Mbylljes progresive të veprimtarisë minerare.
- b) Garantimit të mbylljes së sigurt të veprimtarisë minerare.
- c) Garantimit të demolimit të sigurt të objekteve të veprimtarisë minerare, që nuk mund të përdoren më tej pas përfundimit të kësaj veprimtarie, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi.
- d) Realizimit të përfundimit të procesit të mbylljes së objekteve minerare të ish-ndërmarrjeve shtetërore minerare.
- e) Garantimit të një procesi mbylljeje me një emetim sa më të vogël në mjedis dhe garantimit të monitorimit postminerar.
- f) Bashkëpunimit dhe veprimet e përbashkëta ndërmjet autoriteteve të qeverisjes qendrore dhe asaj vendore.
- g) Rehabilitimit të pjesëve të dëmtuara të mjedisit.

3. Parimet bazë për hartimin e planit të menaxhimit të mbetjeve minerare të veprimtarisë minerare mbështeten në legjislacionin minerar dhe mjedisor në fuqi. Këto parime përfshijnë konceptet e:

- a) Qëllimit të ndotjes së nivelit më të ulët në tokë, në ujërat, te flora e fauna dhe në ekosistemin, në përgjithësi, dhe në përputhje me vlerat minimale, të pranuar sipas legjislacionit në fuqi.
- b) Promovimit dhe inkurajimit të proceseve të riciklimit, që sasia e depozituar e mbetjeve të jetë sa më e vogël.
- c) Garantimit të një vendi dhe mënyre depozitimi të mbetjeve në mënyrë të sigurt që ato të mos përbejnë rrezik për mjedisin e komunitetin në të ardhmen, duke respektuar kërkesat mjedisore dhe kërkesat e shkarkimeve, të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për mjedisin.
- d) Garantimit të një emetimi minimal të shkarkimeve të elementeve të dëmshme në mjedis.
- e) Trajtimit të mbetjeve minerare sipas karakteristikave të tyre, përbërjes, dekompozimit.
- f) Inkurajimit të përdorimit të produkteve më miqësore ndaj mjedisit dhe teknikave më të mira të disponueshme.

l) Parandalimit dhe marrjes së masave paraprake në mënyrë që të eliminojnë ngjarjet aksidentale dhe parandalojnë apo në rast se nuk është e mundur, të minimizojnë dukurinë e efekteve negative në mjedis dhe të garantojnë marrjen e masave efektive në kohë dhe me kosto më të ulët.

g) Garantimit të monitorimit të efekteve të mbetjeve nëpërmjet vazhdimësisë së monitorimit dhe mbajtjes së një informacioni të hollësishëm për punimet e kryera për depozitim dhe për trajtimin e mbetjeve minerare.

h) Bashkëpunimit dhe veprimet e përbashkëta ndërmjet autoriteteve të qeverisjes qendrore dhe asaj vendore.

i) Bashkërendimit ndërmjet mbrojtjes së mjedisit dhe zhvillimit ekonomik.

4. Parimet bazë të përcaktimit të zonës së rrezikshme të një të drejte minerare, mbështeten në legjislacionin minerar dhe mjedisor në fuqi. Këto parime përfshijnë konceptet e:

- a) Garantimit të realizimit të veprimtarive minerare në mënyrë të sigurt, duke eliminuar rrezikun minerar.
- b) Garantimit të jetës dhe shëndetit të punonjësve dhe banorëve të zonës përreth zonës minerare.
- c) Përcaktimeve të sakta të kontureve të zonës së rrezikshme të një lejeje minerare, duke marrë në konsideratë efektin e veprimtarisë minerare, si: punimet e shpim-plasjes, emetimit të shkarkimeve, zhurmën, pluhurin, depozitimit të mbetjeve, përpunimin e mineralit.
- d) Garantimit të dëmtimeve të mjedisit, infrastrukturës dhe objekteve të palëve të treta.
- e) Bashkëpunimit dhe veprimet e përbashkëta ndërmjet autoriteteve të qeverisjes qendrore dhe asaj vendore.

5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen institucionet e SHGJSH-së dhe AKBN-së.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS
NASIP NAÇO

URDHËR
Nr.304, datë 13.4.2011

PËR MIRATIMIN E FORMËS DHE PËRMBAJTJES SË PROJEKTIT TË ZHVILLIMIT TË VEPRIMTARISË MINERARE

Në zbatim të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 29 pika 2 dhe 56 pika 2 të ligjit nr.10 304, datë 15.7.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”,

URDHËROJ:

1. Hartimi i projektit të zhvillimit të veprimtarisë minerare realizohet nga persona të licencuar dhe të regjistruar si të tilla nga institucioni i QKL-së për veprimtari studimore-projektuese në fushën minerare, në përputhje me kërkesat e nenit 33 të ligjit nr.10 304, datë 15.7.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, dhe akteve nënligjore të dalta në zbatim të tij.

2. Forma dhe përmbajtja e projektit të zhvillimit të veprimtarisë minerare për kërkesat për leje minerare të kërkim-zbulimit për grupin e mineraleve metalore, jometalore, qymyret dhe bitumet përshkruhen në aneksin 1 të këtij urdhri.

3. Forma dhe përmbajtja e projektit të zhvillimit të veprimtarisë minerare për kërkesat për leje minerare të shfrytëzimit për grupin e mineraleve metalore, jometalore, qymyret dhe bitumet përshkruhen në aneksin 2 të këtij urdhri.

4. Forma dhe përmbajtja e projektit të zhvillimit të veprimtarisë minerare për kërkesat për leje minerare të kërkim-zbulimit për grupin e mineraleve ndërtimore përshkruhen në aneksin 3 të këtij urdhri.

5. Forma dhe përmbajtja e projektit të zhvillimit të veprimtarisë minerare për kërkesat për leje minerare të shfrytëzimit me karrierë për grupin e mineraleve ndërtimore përshkruhen në aneksin 4 të këtij urdhri.

6. Forma dhe përmbajtja e projektit të zhvillimit të veprimtarisë minerare për kërkesat për leje minerare të kërkim-zbulim-shfrytëzimit për grupin e mineraleve të çmuara dhe gjysmë të çmuara përshkruhen në aneksin 5 të këtij urdhri.

7. Forma dhe përmbajtja e projektit të zhvillimit të veprimtarisë minerare për kërkesat për leje minerare të kërkim-zbulimit dhe shfrytëzimit për grupin e mineraleve radioaktive përshkruhen në aneksin 6 të këtij urdhri.

8. Grupi i hartimit të projektit të zhvillimit të veprimtarisë minerare për lejet minerare të kërkim-zbulimit duhet të përbëhet nga inxhinierë të licencuar me drejtimit e mëposhtme:

- a) Inxhinier gjeolog;
- b) Inxhinier topograf ose markshajder;
- c) Inxhinier shpimi (kur projekti përmban punime shpimi);
- d) Inxhinier gjeofizik (kur projekti përmban punime gjeofizike);
- e) Ekonomist.

9. Grupi i hartimit të projektit të zhvillimit të veprimtarisë minerare për lejet minerare të shfrytëzimit duhet të përbëhet nga inxhinierë të licencuar me drejtimit e mëposhtme:

- a) Inxhinier miniere;
- b) Inxhinier gjeolog;
- c) Inxhinier topograf ose markshajder (kur veprimtaria e shfrytëzimit bëhet me karrierë/minierë);
- d) Inxhinier pasurues (kur projekti përmban objekte të seleksionimit, thyerje, fraksionimit apo pasurimit të mineraleve);
- e) Inxhinier metalurg (kur projekti përmban procese metalurgjike gjatë përpunimit të mineraleve);
- f) Ekonomist.

10. Institucioni i SHGJSH-së ose AKBN-së në rastet e kërkesave për leje minerare të kërkim-zbulimit ose shfrytëzimit për grupin e mineraleve radioaktive, për vlerësimin e projekteve të paraqitura kanë të drejtë të kërkojnë asistencë teknike për vlerësimin e tyre.

11. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet institucioni i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN), Shërbimi Gjeologjik Shqiptar (SHGJSH) dhe Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL). Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS
NASIP NAÇO

ANEKSI 1

FORMA DHE PËRMBAJTJA E PROJEKTIT TË ZHVILLIMIT TË VEPRIMTARISË MINERARE PËR KËRKESAT PËR LEJE MINERARE TË KËRKIM-ZBULIMIT PËR GRUPIN E MINERALEVE METALORE, JOMETALORE, QYMYRET DHE BITUMET

Përmbajtja e projektit të zhvillimit të veprimtarisë minerare të kërkim-zbulimit për zonën minerare nr....., publikuar në planin vjetor minerar të vitit.....

A. Pjesa narrative e projektit të zhvillimit të veprimtarisë minerare të kërkim-zbulimit për kërkesat për leje minerare të kërkim-zbulimit për grupin e mineraleve metalore, jometalore, qymyret dhe bitumet do të ketë përmbajtjen e mëposhtme:

1. Konsiderata të përgjithshme

a) Të dhëna mbi subjektin që ka aplikuar për marrje leje minerare:

i) Emri i subjektit sipas regjistrimit në QKR:

ii) Zona minerare me numër identifikues nr....., për të cilën kërkohet leja minerare e kërkim-zbulimit dhe që përfshihet në planin vjetor minerar të miratuar për vitin

iii) Lloji i mineralit/mineraleve për të cilin kërkohet dhënie leje :

iv) Emri dhe mbiemri i administratorit të subjektit aplikues për leje minerare sipas regjistrimit në QKR:

v) Adresa e selisë së subjektit sipas regjistrimit në QKR:

vi) Nr. i telefonit / faksit:

vii) Emërtimi i njësisë vendore/njësisive vendore ku përfshihet zona e kërkuar:

viii) Emri dhe mbiemri i drejtuesit teknik:

ix) Data e përfundimit të licencës profesionale të drejtuesit teknik:/...../.....

b) Një përshkrim të kapaciteteve teknike, profesionale dhe menaxheriale të kërkuesit që i vlejnjë kërkuesit për realizimin e veprimtarisë së kërkim-zbulimit, duke përfshirë edhe *Curriculum Vitae* të stafit të tij që do të punojë për këtë veprimtari, si dhe përshkrim të eksperiencës së tij të mëparshme në fushën e industrisë minerare, nëse ka.

2. Baza ligjore mbi të cilën subjekti kërkon të hartohet projekti, si:

a) Niveli i parashikuar i investimit, sipas kërkesave të përcaktuara për nivelet e investimit për sipërfaqe të zonës së lejuar. Niveli i parashikuar i investimit përputhet me fazat e zhvillimit të programit të punës për projektin konkret: Me fazë kërkimi e në vijim fazë zbulimi, apo vetëm me fazë zbulimi. Programi minimal i punës i propozuar për lejen e kërkim-zbulimit nuk duhet të jetë më i vogël në vlerë sesa produkti i sipërfaqes së kërkuar për leje me vlerën e caktuar monetare të shpenzohet për çdo kilometër katror të sipërfaqes, ky sipas tabelës të përcaktuar me aktet nënligjore të ligjit nr.10 304, datë 15.7.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”. Niveli i parashikuar i programit minimal të punës përputhet me fazat e zhvillimit të programit të punës për projektin konkret: Me fazë kërkimi e në vijim fazë zbulimi, apo vetëm me fazë zbulimi.

b) Format i përshkrues i zonës minerare që kërkohet për leje kërkim-zbulimi sipas përcaktimeve të akteve nënligjore të ligjit nr.10 304, datë 15.7.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”.

c) Pasqyrimi i dokumentacionit që vërteton burimin e të dhënave gjeologjike të përdorura për realizimin e projektit të veprimtarisë minerare të kërkim-zbulimit.

d) Përcaktimi i vlerës së garancisë financiare për realizimin e programit minimal të punës, sipas fazave të zhvillimit të programit të punës në kërkim e zbulim apo direkt në zbulim.

3. Përshkrimi i shkurtër gjeografiko-ekonomik, vendndodhja administrative dhe topografike e objektit

a) Gjeografia e zonës, relievi, klima, bimësia;

- b) Hidrografia, hidrogeologjia;
- c) Demografia, infrastruktura ekzistuese etj.;
- d) Ekonomia e zonës dhe aktivitetet kryesore.

4. Përshkrim i shkurtër i ndërtimit gjeologo-tektonik dhe për mineralet e dobishme të zonës së kërkuar dhe për vendburimet dhe objektet e njohura

- a) Llojet, stratigrafia dhe moshja e shkëmbinjve që marrin pjese në ndërtimin e rajonit;
- b) Zhvillimi i tektonikave kryesore;
- c) Të dhëna të shkurtra mbi mineralet që ndodhen në rajon, shoqëruar me hartën gjeologjike të saj në shkallë (1:10 000 – 1:50 000), historiku i studimeve dhe punimeve të kryera, rezultatet e tyre;
- d) Mineralet e dobishme të zonës nga të dhënat arkivore, përshkrim më të plotë për mineralin apo mineralet për të cilët kërkohet leja;
- e) Vendburimet dhe objektet e njohura;
- f) Vendburimet e shfrytëzuara apo në shfrytëzim;
- g) Rezervat e njohura sipas vendburimeve dhe objekteve, sasia dhe cilësia e tyre;
- h) Të dhëna mbi mineralizimin;
- i) Të dhëna mbi morfologjinë dhe teksturën e trupit (trupave) xeheror.

5. Mënyra e propozuar e kërkim-zbulimit të mineraleve

Në mënyrën e propozuar të kërkim-zbulimit përcaktohen fazat e zhvillimit të programit të punës, nëse programi i punës parashikon zbatimin e tij në dy faza: atë të kërkimit dhe në vijim atë të zbulimit apo direkt në fazën e zbulimit.

Kur programi i punës parasheh realizimin e tij vetëm me fazën e zbulimit jepen vëllimet e punës të programuara me zërat, si më poshtë.

Kur programi parasheh realizimin me dy faza: jepen të plota sipas zërave vëllimet e punës për fazën e parë. Me mbylljen e kësaj faze, varësisht nga rezultatet e saj dhe objektivat e subjektit zotërues të lejes, jepen vëllimet e punës sipas zërave për fazën e dytë:

- a) Marshuta rikonjicioni (në km);
- b) Rilevime topografike (në km²);
- c) Rilevime gjeologjike (në km²);
- d) Punime gjeofizike;
- e) Punime minerare sipërfaqësore si: pastrime, kanale (në m³);
- f) Punime minerare nëntokësore si: galeri, puse (në ml);
- g) Punime shpimi (në ml).

6. Përshkrim i programit të kërkim-zbulimit të propozuar

- a) Studimet gjeologjike dhe punimet e projektuara në zonën e kërkuar për leje kërkim-zbulimi;
- b) Studime hidrogeologjike;
- c) Studime teknologjike;
- d) Vlerësimi dhe rivlerësimi i rezervave minerare;
- e) Fazat e kryerjes së tyre sipas afateve (punime kërkimi, punime zbulimi), sipas llojeve të tyre (gjeologjike, gjeokimie, gjeofizike);
- f) Projektet teknike për secilin nga sheshet, vendburimet apo objektet;
- g) Projektet teknike hartohen në përputhje me fazat e zhvillimit të programit të punës së përshkruar më lart.

Në këto projekte duhet të jepen:

- i) Argumentimi i punimeve që projektohen;
- ii) Lloji dhe vëllimi i punimeve të projektohen;
- iii) Kostoja e tyre;
- iv) Afatet e programuara të realizimit të tyre;
- v) Ilustrimi grafik me harta, projeksione, profile etj., në shkallën e duhur për secilin shesh, vendburim, objekt dhe punim të projektuar në fazën e aplikimit për leje kërkim-zbulimi.

7. Përshkrim i infrastrukturës së nevojshme për realizimin e projektit të zhvillimit të veprimtarive minerare

- a) Rrugë automjetesh për realizimin e punimeve të kërkim-zbulimit;
- b) Sheshet e punimeve të kërkim-zbulimit;

c) Ngritja e kantierit (zyra, pajisje orendi dhe ambiente të tjera, si: banja, gardërobë, fjetore, mensë, magazinë materialesh, kabina elektrike, gjenerator, stacion pompimi, depoja e lëndës plasëse etj.).

8. Programi minimal i punës të kërkim-zbulimit të propozuar

Programi minimal i punës të propozuar ndërtohet sipas fazave të zhvillimit të programit të punës së paraparë: në kërkim e pastaj në zbulim apo direkt në zbulim ku jepen.

a) Operacionet e kërkim-zbulimit të programuara që minimalisht do të realizohen për t'u kryer në tërësi për lejen minerare dhe për secilin shesh, vendburim dhe objekt;

b) Për punimet e programuara të jepet:

i) vëllimi i tyre;

ii) shpenzimet e programuara për secilin zë dhe në tërësi.

c) Mbi bazën e kostove të operacioneve të kërkim-zbulimit të përcaktohet vlera financiare për realizimin e programit minimal të punës dhe përcaktimi i vlerës së garancisë financiare për realizimin e programit minimal të punës.

9. Të dhëna lidhur me punësimin dhe specializimin e shtetasve shqiptarë

10. Të dhëna mbi identifikimin e ndikimeve në mjedis gjatë hapjes së punimeve minerare

a) Dëmtimi i sipërfaqes së tokës, erozioni gjatë hapjes dhe kryerjes së punimeve dhe masat për dëmtimet të sipërfaqes së tokës nga operacionet e gërmimit;

b) Dëmtimi i florës, faunës dhe bimët e ujit dhe masat parandaluese e rehabilituese;

c) Shkarkimet e ujërave, pluhurat gjatë procesit të punës, zhurmat, emetimi i gazrave nga pajisjet, mjeteve motorike dhe makineritë dhe masat përkatëse;

d) Masat për rigjenerimin e peizazhit;

e) Ndikimi në infrastrukturën e zonës së objektit dhe masat përkatëse;

f) Ndikim në shëndetin e njerëzve që punojnë në objekt dhe në jetën e banorëve përreth, qarkullimin dhe transportin dhe masat përkatëse;

g) Plani i monitorimit të mjedisit.

11. Përfundime dhe rekomandime

B. Pjesa tabelore e projektit të zhvillimit të veprimtarisë minerare të kërkim-zbulimit për kërkesat për leje minerare të kërkim-zbulimit për grupin e mineraleve metalore, jometalore, qymyret dhe bitumet do të përbëhet nga tabelat e mëposhtme:

Tabelat përmbledhëse dhe të detajuara të investimeve dhe grafiku i realizimit të tyre përputhen me fazat e zhvillimit të programit të punës për projektin konkret; përkatësisht me fazë kërkimi e në vijim fazë zbulimi, apo vetëm me fazë zbulimi.

1. Tabela përmbledhëse e investimeve dhe grafiku i kryerjes

| Nr. | Investime | Vlefta e plotë 000/lekë | Viti I .../.../.. - .../.../.. | Viti II .../.../.. - .../.../.. | Viti III .../.../.. - .../.../.. |
|-----|--|----------------------------|--------------------------------------|---------------------------------------|--|
| 1 | Studim, projektim, vlerësim | | | | |
| 2 | Ngritje kantieri | | | | |
| 3 | Makineri, pajisje | | | | |
| 4 | Hapje rrugësh dhe sheshesh | | | | |
| 5 | Investime (punime sipërfaqësore dhe nëntokësore, shpime) | | | | |
| 6 | Testime kimike dhe teknologjike | | | | |
| 7 | Investime për rigjenerim mjedisi | | | | |
| | Totali i investimeve | | | | |

2. Tabela e detajuar për zërat e investimeve për vitin e parë (e njëjta tabelë duhet të parashikohet për vitin e dytë dhe të tretë)

| Nr. | Emërtimi | Tremujori I | | Tremujori II | | Tremujori III | | Tremujori IV | |
|-----|---|-------------|------|--------------|------|---------------|------|--------------|------|
| | | Lekë | Sasi | Lekë | Sasi | Lekë | Sasi | Lekë | Sasi |
| 1.a | Studim | | | | | | | | |
| 1.b | Projektim | | | | | | | | |
| 1.c | Vlerësim | | | | | | | | |
| 2.a | Zyra, mjedise pune, pajisje orendi | | | | | | | | |
| 2.b | Ambiente për punonjësit, banjë, gardërobë, fjetore, mensë | | | | | | | | |
| 2.c | Magazinë materialesh, kabina elektrike, gjenerator | | | | | | | | |
| 2.d | Stacion pompimi, depoja e lëndës plasëse | | | | | | | | |
| 2.e | Etj. | | | | | | | | |
| 3.a | Mjete transporti | | | | | | | | |
| 3.b | Makineri, sonda etj. | | | | | | | | |
| 3.c | Pajisje | | | | | | | | |
| 3.d | Etj. | | | | | | | | |
| 4.a | Hapje rrugësh | | | | | | | | |
| 4.b | Hapje sheshesh | | | | | | | | |
| 5.a | Punime sipërfaqësore | | | | | | | | |
| 5.b | Punime nëntokësore | | | | | | | | |
| 5.c | Shpime | | | | | | | | |
| 5.d | Etj. | | | | | | | | |
| 6.a | Analiza kimike | | | | | | | | |
| 6.b | Analiza teknologjike | | | | | | | | |
| 6.c | Analiza të tjera | | | | | | | | |
| 6.d | Etj. | | | | | | | | |
| 7.a | Mbyllja e punimeve të zbulimit | | | | | | | | |
| 7.b | Menaxhim i mbetjeve | | | | | | | | |
| 7.c | Rehabilitim mjedisi | | | | | | | | |
| | Investimi total | | | | | | | | |

3. Të dhëna për fuqinë punëtore

| Nr. | Emërtimi | Tremujori I | | Tremujori II | | Tremujori III | | Tremujori IV | |
|-----|---|-------------|------|--------------|------|---------------|------|--------------|------|
| | | Sasi | Lekë | Sasi | Lekë | Sasi | Lekë | Sasi | Lekë |
| 1 | Numri i personelit inxhiniero-teknik | | | | | | | | |
| 2 | Numri total i punonjësve | | | | | | | | |
| 3 | Pagesa e punonjësve | | | | | | | | |
| 4 | Pagesat për sigurimin e jetës | | | | | | | | |
| 5 | Pagesat për sigurimet shoqërore | | | | | | | | |
| | Totali i pagesave për punonjësit | | | | | | | | |

4. Tabela përmbledhëse e programit minimal të punës

Tabelat përmbledhëse të programit minimal të punës përputhen me fazat e zhvillimit të programit të punës për projektin konkret; përkatësisht me fazë kërkimi e në vijim fazë zbulimi, apo vetëm me fazë zbulimi.

| Nr. | Emërtimi | Tremujori I | | | Tremujori II | | | Tremujori III | | | Tremujori IV | | |
|-----|--|-----------------|------|------|-----------------|------|------|-----------------|------|------|-----------------|------|------|
| | | Njësia | Sasi | Lekë | Njësia | Sasi | Lekë | Njësia | Sasi | Lekë | Njësia | Sasi | Lekë |
| 1 | Marshuta rikonjicioni | km | | | km | | | km | | | km | | |
| 2 | Rilevim gjeologo-topografik | km ² | | | km ² | | | km ² | | | km ² | | |
| 3 | Punime gjeofizike | km | | | km | | | km | | | km | | |
| 4 | Punime shpimi | m | | | m | | | m | | | m | | |
| 5 | | | | | | | | | | | | | |
| 6 | Etj..... | | | | | | | | | | | | |
| | Vlera totale e programit minimal të punës | | | | | | | | | | | | |
| | Vlera e garancisë financiare për realizimin e programit minimal të punës | | | | | | | | | | | | |

C. Pjesa grafike e projektit të zhvillimit të veprimtarisë minerare të kërkim-zbulimit për kërkesat për leje minerare të kërkim-zbulimit për grupin e mineraleve metalore, jometalore, qymyret dhe bitumet do të jetë sipas tabelës së mëposhtme:

| Nr. | Emërtimi | Shkalla |
|-----|---|---------------------|
| 1 | Harta topografike me zonën e kërkuar dhe koordinatat përkatëse | 1:25000 |
| 2 | Harta topografike me zonën e kërkuar me dokumentimin e infrastrukturës që do të ngrihet për realizimin e projektit | 1:10000 ose 1:5000 |
| 3 | Harta gjeologjike me punimet që do të kryhen për kërkim-zbulimin e xeherorit (marshuta, kanale, puse, galeri shpime, punime gjeofizike) | 1:10000 deri 1:2000 |
| 4 | Profilet gjatësore e tërthore gjeologo-topografike, sipas rrjetit të përcaktuar me punimet e projektuara të kërkim-zbulimit | 1:5000 deri 1:1000 |
| 5 | Projeksioni vertikal ose horizontal me gjeometrizimin e trupave xeheror të prishëm | 1:2000 deri 1:1000 |

ANEKSI 2

FORMA DHE PËRMBAJTJA E PROJEKTIT TË ZHVILLIMIT TË VEPRIMTARISË MINERARE PËR KËRKESAT PËR LEJE MINERARE TË SHFRYTËZIMIT PËR GRUPIN E MINERALEVE METALORE, JOMETALORE, QYMYRET DHE BITUMET

Përmbajtja e projektit të zhvillimit të veprimtarisë minerare të shfrytëzimit për zonën minerare nr....., publikuar në planin vjetor minerar të vitit.....

A. Pjesa narrative e projektit të zhvillimit të veprimtarisë minerare të shfrytëzimit për kërkesat për leje minerare të shfrytëzimit për grupin e mineraleve metalore, jometalore, qymyret dhe bitumet do të ketë përmbajtjen e mëposhtme:

1. Konsiderata të përgjithshme

a) Të dhëna mbi subjektin që ka aplikuar për marrje leje minerare:

i) Emri i subjektit sipas regjistrimit në QKR:

ii) Zona minerare me numër identifikues nr....., për të cilën kërkohet leja minerare e shfrytëzimit dhe që përfshihet në planin vjetor minerar të miratuar për vitin

iii) Lloji i mineralit/mineraleve për të cilin kërkohet dhënia e lejes:

iv) Emri dhe mbiemri i administratorit të subjektit aplikues për leje minerare sipas regjistrimit në QKR:

v) Adresa e selisë së subjektit sipas regjistrimit në QKR:

vi) Nr. i telefonit / faksit:

vii) Emërtimi i njësisë vendore/njësive vendore ku përfshihet zona e kërkuar:

viii) Emri dhe mbiemri i drejtuesit teknik:

ix) Data e përfundimit të licencës profesionale të drejtuesit teknik:/...../.....

b) Një përshkrim të kapaciteteve teknike, profesionale dhe menaxheriale të kërkuesit që i vlejné kërkuesit për realizimin e veprimtarisë së shfrytëzimit, duke përfshirë edhe *Curriculum Vitae* të stafit të tij që do të punojë për këtë veprimtari, si dhe përshkrim të eksperiencës së tij të mëparshme në fushën e industrisë minerare, nëse ka.

2. Baza ligjore mbi të cilën subjekti kërkon të hartohet projekti, si:

a) Niveli i parashikuar i investimit, sipas kërkesave të përcaktuara për nivelet e investimit për sipërfaqe të zonës së lejuar. Programi i investimit i propozuar për lejen e shfrytëzimit nuk duhet të jetë më i vogël në vlerë sesa produkti i sipërfaqes së kërkuar për leje me vlerën e caktuar monetare të shpenzohet për çdo kilometër katror të sipërfaqes, ky sipas tabelës së përcaktuar me aktet nënligjore të ligjit nr.10 304, datë 15.7.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”.

b) Format i përshkrues i zonës minerare që kërkohet për leje shfrytëzimi sipas përcaktimeve të akteve nënligjore të ligjit nr.10 304, datë 15.7.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”;

c) Pasqyrimi i dokumentacionit që vërteton burimin e të dhënave gjeologo-minerare të përdorura për realizimin e projektit të veprimtarisë minerare të kërkim-zbulimit.

d) Përcaktimi i vlerës së garancisë financiare vjetore për realizimin e programit të investimit.

3. Përshkrimi i shkurtër gjeografiko-ekonomik, vendndodhja administrative dhe topografike e objektit

a) Konsiderata të përgjithshme, vendndodhja e objektit;

b) Gjeografia e zonës, relievi, klima, bimësia;

c) Rilevimi i zonës që kërkohet me koordinatat përkatëse në plan, ndërtesat ekzistuese ose ndonjë objekt tjetër brenda zonës;

d) Hidrografia, hidrogeologjia;

e) Demografia, infrastruktura ekzistuese etj.;

f) Ekonomia e zonës dhe aktivitetet kryesore.

4. Përshkrim i ndërtimit gjeologo-tektonik dhe për mineralet e dobishme të zonës së kërkuar dhe për vendburimet dhe objektet e njohura

1. Llojet, stratigrafia dhe moshën e shkëmbinjve që marrin pjesë në ndërtimin e rajonit dhe vendburimit.

2. Zhvillimi i tektonikave kryesore, tektonika e vendburimit. Mbi zhvillimin e tektonikes shkëputëse dhe çashmërisë.

3. Kushtet hidrogeologjike dhe rrjeti hidrografik i rajonit.

4. Kushtet hidrografike dhe hidrogjeologjike të vendburimit.
 5. Vendburimet dhe objektet e njohura.
 6. Vendburimet e shfrytëzuara apo në shfrytëzim.
 7. Rezervat e njohura sipas vendburimeve dhe objekteve, sasia dhe cilësia e tyre.
 8. Mbi morfologjinë dhe përbërjen e xeherorit dhe/ose xeherorëve të dobishëm. Të dhëna të shkurtra mbi llojin e mineralit.
 9. Vendndodhja e vendburimit dhe elementet topografike të saj.
 10. Vendosja e trupit xeheror, shkëmbinjtë e tavanit dhe dyshemesë.
 11. Elementet gjeometrike të vendosjes në hapësirë të trupit dhe/ose trupave xeherorë.
 12. Lloji i kontaktit me shkëmbinjtë rrethues.
 13. Trashësia dhe lloji i mbulesës dhe elementet gjeometrike të tyre.
 14. Vetitë fiziko-mekanike të shkëmbinjve.
 15. Vetitë fiziko-mekanike të xeherorit të dobishëm.
 16. Punimet e kryera (rilevime, kanale, puse, galeri, shpime, metoda gjeofizike etj., që kanë shërbyer për zbulimin e vendburimit, metoda e llogaritjes së rezervave dhe tabela e llogaritjes së rezervave të mineralit, rezervat gjeologjike dhe të nxjerrshme të mineralit në sasi e cilësi.
 17. Të dhëna mbi mineralizimin dhe karakteristikat e trupave xeherore.
 18. Të dhëna të shkurtra mbi mineralet që ndodhen në rajon, shoqëruar me hartën gjeologjike të saj në shkallë (1:10 000 – 1:50 000), historiku i studimeve dhe punimeve të kryera, rezultatet e tyre.
 19. Mineralet e dobishme të zonës nga të dhënat arkivore, përshkrim më të plotë për mineralin apo mineralet për të cilët kërkohet leja.
 20. Përbërja mineralogjike e trupit xeheror.
 21. Përmbajtja e elementeve të dobishëm.
5. Mënyra e propozuar e shfrytëzimit dhe/ose përpunimit të mineraleve:
- a) Përshkrim i sistemit të shfrytëzimit që do të aplikohet;
 - b) Përshkrim i proceseve të seleksionimit, thyerjes, fraksionimit, pasurimit apo metodave të tjera që do të përdoren për përpunimin e mineralit dhe realizimin e produkteve të parashikuara, me skemat përkatëse teknologjike dhe treguesit.
6. Përshkrim i programit të shfrytëzimit dhe/ose përpunimit të mineraleve të propozuara
- 6.1 Rezervat që merren parasysh në projektim, ndarë sipas horizonteve dhe profileve, shoqëruar me tabelën përkatëse.
 - 6.2 Kushtet tekniko-minerare të vendburimit
Parametrat e trupit, trupave ose zonës së mineralizuar:
 - a) Shtrirja m;
 - b) Trashësia m;
 - c) Zhytja m (nga kuota + deri në kuotën +);
 - d) Këndi i zhytjes gradë;
 - e) Kondicioni;
 - f) Sasia e ujërave nëntokësore m³/min ose l/sek.
 - 6.3 Zgjedhja e mënyrës së shfrytëzimit, me punime sipërfaqësore apo me punime nëntokësore argumentimi i saj.
 - 6.4 Hapja e minierës:
 - a) Variantet e hapjes së vendburimit:
 - i) Për vendburime të reja;
 - ii) Për rihapje ose hapje të minierave ekzistuese ose zonave të veçanta të tyre, përshkrimi i gjendjes teknike e punimeve ekzistuese.
 - 6.5 Studimi dhe përshkrimi i varianteve të hapjes, në varësi të punimeve të hapjes dhe përgatitjes së minierës bllokut ose zonës, punimeve ekzistuese dhe gjendjes teknike të tyre, për hapjen e minierës, ose rihapjen e zonës (objektit), si më poshtë:
 - a) Variantet e hapjes me shfrytëzimin e punimeve ekzistuese;
 - b) Variantet e hapjes me punime të reja;
 - c) Pasaportat teknike të hapjes dhe armatimit të punimeve të hapjes, përgatitjes dhe shfrytëzimit (nëntoka);

d) Krahasimi tekniko-ekonomik dhe zgjedhja e variantit më të përshtatshëm nëpërmjet të dhënave për secilin, si: sasia e punimeve, çmimi për njësi, vlera;

e) Punimet e hapjes së vendburimit për pjesën që do të shfrytëzohet me nëntokë;

f) Grafiku i kryerjes së punimeve të hapjes, përgatitjes dhe shfrytëzimit.

6.6 Kapaciteti prodhues dhe jeta e minierës:

a) Përcaktimi i kapacitetit prodhues;

b) Përcaktimi i jetës së minierës;

c) Radha dhe drejtimi i shfrytëzimit dhe grafikët përkatës në vite.

6.7 Punimet kryesore të hapjes:

a) Përshkrimi i punimeve kryesore të hapjes;

b) Përcaktimi i koordinatave të pikave të fillimit, fundore dhe të intersektimit për punimet kryesore të hapjes, seksionit dhe llojit të armatimit.

6.8 Pasaportat e shpim-plasjes për zbulimin në karrierë dhe frontet e prodhimit dhe llogaritja e lëndës eksplozive që do të përdoret.

6.9 Përcaktimi i lartësisë së katit:

a) Ndarja e minierës në horizonte, numri dhe kuota e tyre respektive;

b) Konditat tekniko-minerare të shfrytëzimit;

c) Përshkrimi i trupave xeherorë, ose zonës së mineralizuar;

d) Zgjedhja dhe përshkrimi i sistemit dhe /ose sistemeve të shfrytëzimit;

e) Grafiku i zhvillimit të punimeve të shtrihet në aq vite sa vazhdon kryerja e punimeve;

f) Grafiku i prodhimit, të shtrihet në aq vite sa vazhdon prodhimi i minierës.

6.10 Depozitimi i sterilizimit dhe mineralit ose të nënprodukteve:

a) Përcaktimi i vendit të depozitimit të mineralit ose të nënprodukteve. Llogaritja e kapacitetit depozitues;

b) Përcaktimi i sheshit të depozitimit të sterilizimit. Llogaritja e kapacitetit depozitues.

6.11 Mekanizimi i proceseve të punës në nëntokë:

a) Impiantet ngritëse. Llogaritja e kapacitetit dhe zgjedhja e tipit të mekanizmit ngritës;

b) Procesi i rrëzimit. Përcaktimi i mjetit të rrëzimit. Llogaritja e numrit të mjetit të rrëzimit;

c) Procesi i ngarkimit në front. Llogaritja e kapacitetit dhe zgjedhja e tipit të mekanizmit ngarkues;

d) Transporti i brendshëm. Llogaritja e kapacitetit dhe zgjedhja e tipit të mjeteve transportuese;

e) Skema e transportit të përgjithshëm. Llogaritja e kapacitetit dhe zgjedhja e tipit të mjeteve transportuese të përgjithshme;

f) Pasqyra përmbledhëse e pajisjeve dhe mekanizmave që do të përdoren nëntokë dhe sipërfaqe për procesin e shfrytëzimit, si më poshtë.

6.12 Ajrimi i minierës:

a) Përcaktimi i llojit të ajrimit të minierës;

b) Përcaktimi i skemës së ajrimit;

c) Të dhënat kryesore për llogaritjen e sistemit të ajrimit;

d) Llogaritja e sasisë së nevojshme të ajrit;

e) Llogaritja e depresionit;

f) Llogaritja e humbjes së presionit në minierë;

g) Përcaktimi i tipit të ventilatorit në funksion të sasisë së ajrit, depresionit dhe rezistencës së llogaritur;

h) Për minierat me regjim gazi përcaktimi i masave shtesë për matjen dhe monitorimin e regjimit të ajrit, në përputhje me rregulloren e sigurimit teknik në fuqi;

i) Skema e ajrimit, llogaritjet përkatëse dhe zgjedhja e ventilatorit për hapjen e punimeve të gjata.

6.13 Furnizimi me ajër të ngjeshur:

a) Skema e furnizimit me ajër të ngjeshur;

b) Llogaritjet e nevojave për ajër të ngjeshur dhe në bazë të saj përcaktimi i prodhimitarisë, numrit dhe tipit të kompresorëve;

c) Llogaritjet e rrjetit të shpërndarjes së ajrit të ngjeshur;

6.14 Shpimi i lagur në minierë:

a) Skema e furnizimit me ujë për shpimin e lagur;
b) Llogaritjet e nevojave për ujë të ngjeshur dhe në bazë të saj llogaritjet e rrjetit të shpërndarjes së ujit në minierë;

c) Lufta kundër pluhurit.

6.15 Largimi i ujërave nga miniera:

- a) Përcaktimi i sasisë së ujit dhe mënyrës së largimit të tij;
- b) Llogaritja e pompave dhe tubacioneve për largimin e ujit;
- c) Përcaktimi i stacioneve të pompimit, ujëmbledhësit dhe kapacitetit të tij.

6.16 Organizimi dhe fuqia punëtore dhe paga mesatare.

6.17 Sigurimi teknik në proceset e punës për hapjen, shfrytëzimin dhe administrimin e objektit

6.18 Furnizimi me energji elektrike:

- a) Përcaktimi i skemës së furnizimit me energji elektrike në sipërfaqe dhe nëntokë;
- b) Përcaktimi i ngarkesës elektrike;
- c) Zgjedhja e fuqisë së transformatorit;
- d) Llogaritja e linjave të furnizimit me energji në sipërfaqe dhe nëntokë;
- e) Ngarkesat elektrike për konsumatorët e sipërfaqes dhe të nëntokës për periudhën e hapjes

përgatitjes dhe shfrytëzimit të minierës.

6.19 Makineritë dhe pajisjet e minierës:

- a) Baza mekanike e riparimit dhe mirëmbajtjes;
- b) Lista e përgjithshme e makinerive e pajisjeve energo-mekanike dhe preventivi përkatës.

6.20 Përshkrimi i objekteve sipërfaqësore dhe të nëntokës:

- a) Rrugët automobilistike për hapjen dhe shfrytëzimin e objektit;
- b) Sistemime për sheshet e ndërtimit të objekteve sipërfaqësore;
- c) Zyra dhe ambiente të tjera;
- d) Banjë gardërobë;
- e) Fjetore;
- f) Mensë;
- g) Magazinë materialesh;
- h) Sallë kompresorësh;
- i) Kabina elektrike;
- j) Stacion pompimi;
- k) Ofiçina dhe garazhi i automjeteve;
- l) Depoja e lëndës plasëse (në sipërfaqe ose nëntokë);
- m) Furnizimi me ujë;
- n) Kabina elektrike dhe furnizimi me energji elektrike.

7. Objektet përpunuese, përpunimi i mineralit.

7.1 Marrja dhe përpunimi i kampionit:

- a) Përcaktimi i numrit të mostrave;
- b) Përcaktimi i masës së një mostre;
- c) Përcaktimi i tipave të analizimit të kampionit.

7.2 Studimi mineralogjik i xeherorit:

- a) Përbërja teksturore;
- b) Monomineralet;
- c) Përcaktimi i bashkëveprimit të mineraleve në xeheror;
- d) Përcaktimi i shkallës së çlirimit;
- e) Përcaktimi i shkallës së thyeshmërisë dhe indekseve të bluarjes.

7.3 Analizat laboratorike për përcaktimet e vetive fizike, kimike etj., në varësi të metodës që do të përdoret për trajtimin e xeherorit.

7.4 Përcaktimi i skemës/skemave teknologjike të trajtimit të xeherorit dhe zgjedhja e skemës optimale.

7.5 Përcaktimi i skemës së pajisjeve.

7.6 Projekti përkatës me përlllogaritjet e pajisjeve, sasive të pulpave, koncentrimin të së ngurtës, sasisë së ujit etj.

7.7 Treguesit përfundimtar të trajtimit të xeherorit:

| Produktet | Pesha % | Cilësia e produktit (%) | Rikuperimi (%) |
|------------|---------|-------------------------|----------------|
| Hyrje | 100.00 | ----- | 100.00 |
| Koncentrat | | | |
| Steril | | | |

7.8 Tabela përmbledhëse e investimeve.

7.9 Analiza ekonomike:

- a) Investimet e parashikuara;
- b) Grafiku i kryerjes së investimeve;
- c) Prodhimi dhe llojet e produkteve;
- d) Llogaritja e detajuar e kostos së punimeve minerare dhe prodhimit deri në produktin e shitshëm;
- e) Analiza e çmimeve të produkteve;
- f) Analiza e burimeve të financimit;
- g) Përlllogaritja e efektivitetit të investimit, përcaktimi i NPV-së, me anë të metodës së *Cash-Flow*.

8. Përshkrim i infrastrukturës së nevojshme për realizimin e projektit të veprimtarive minerare

- a) Rrugë automjetesh për realizimin e punimeve të shfrytëzimit dhe përpunimit të mineralit;
- b) Sheshet e punimeve të shfrytëzimit, fabrikave të përpunimit të mineralit dhe depozitimit të mbetjeve;
- c) Ngritja e kantierit (zyra, pajisje, orendi dhe ambiente të tjera, si: banjë, gardërobë, fjetore, mensë, magazinë materialesh, kabina elektrike, gjenerator, stacion pompimi, depoja e lëndës plasëse etj.).

9. Përcaktimi i vlerës së investimit

- a) Për punimet e programuara të jepet:
 - i) vëllimi i tyre;
 - ii) shpenzimet e programuara për secilin zë dhe në tërësi;
- b) Mbi bazën e kostove të operacioneve të shfrytëzimit dhe përpunimit për programin e investimit të bëhet vlerësimi i investimit total dhe përcaktimi i vlerës së garancisë financiare vjetore për realizimin e programit të investimit.

10. Të dhëna lidhur me punësimin dhe specializimin e shtetasve shqiptarë.

11. Të dhëna mbi identifikimin e ndikimeve në mjedis gjatë hapjes së punimeve minerare

- a) Dëmtimi i sipërfaqes së tokës, erozioni gjatë hapjes dhe kryerjes së punimeve dhe masat për dëmtime të sipërfaqes së tokës nga operacionet e gjermimit;
- b) Dëmtimi i florës, faunës dhe bimët e ujit dhe masat parandaluese e rehabilituese.
iii) Lloji i mineralit/mineraleve për të cilin kërkohet dhënia e lejes:

iv) Emri dhe mbiemri i administratorit të subjektit aplikues për leje minerare sipas regjistrimit në QKR:

v) Adresa e selisë së subjektit sipas regjistrimit në QKR:

vi) Nr. i telefonit / faksit:

vii) Emërtimi i njësisë vendore/njësive vendore ku përfshihet zona e kërkuar:

viii) Emri dhe mbiemri i drejtuesit teknik:

ix) Data e përfundimit të licencës profesionale së drejtuesit teknik:/...../.....

b) Një përshkrim të kapaciteteve teknike, profesionale dhe menaxheriale të kërkuesit që i vlejnjë kërkuesit për realizimin e veprimtarisë së kërkim-zbulim-shfrytëzimit, duke përfshirë edhe *Curriculum Vitae* të stafit të tij që do të punojë për këtë veprimtari, si dhe përshkrim të eksperiencës së tij të mëparshme në fushën e industrisë minerare, nëse ka.

2. Baza ligjore mbi të cilën subjekti kërkon të hartohet projekti, si:

a) Niveli i parashikuar i investimit, sipas kërkesave të përcaktuara për nivelet e investimit për sipërfaqe të zonës së lejuar. Programi investimit i propozuar për lejen e shfrytëzimit nuk duhet të jetë më i vogël në vlerë sesa produkti i sipërfaqes së kërkuar për leje me vlerën e caktuar monetare të shpenzohet për çdo kilometër katror të sipërfaqes, ky sipas tabelës të përcaktuar me aktet nënligjore të ligjit nr.10 304, datë 15.7.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”.

b) Formati përshkrues i zonës minerare që kërkohet për leje kërkim-zbulim-shfrytëzimi sipas përcaktimeve të akteve nënligjore të ligjit nr.10 304, datë 15.7.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”.

c) Pasqyrimi i dokumentacionit që vërteton burimin e të dhënave gjeologo-minerare të përdorura për realizimin e projektit të veprimtarisë minerare të kërkim-zbulimit.

d) Përcaktimi i vlerës së garancisë financiare vjetore për realizimin e programit të investimit.

e) Për rastet e përdorimit të skemave të përpunimit me lishivim apo trajtimin kimik, biologjik etj., të xeherorit duhet të respektohen të gjitha kërkesat e planit të depozitimit të mbetjeve minerare dhe planit të mbrojtjes nga aksidentet sipas përcaktimeve të ligjit nr.10 304, datë 15.7.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë” dhe shkarkimeve të përcaktuara në legjislacionin mjedisor.

3. Përshkrimi i shkurtër gjeografiko-ekonomik, vendndodhja administrative dhe topografike e objektit

a) Gjeografia e zonës, relievi, klima, bimësia;

b) Rilevimi të zonës që kërkohet me koordinatat përkatëse në plan, ndërtesat ekzistuese ose ndonjë objekt tjetër brenda zonës;

c) Hidrografia, hidrogeologjia;

d) Demografia, infrastruktura ekzistuese etj.;

e) Ekonomia e zonës dhe aktivitetet kryesore.

4. Përshkrim i ndërtimit gjeologo-tektonik dhe për mineralet e dobishme të zonës së kërkuar dhe për vendburimet dhe objektet e njohura

1. Llojet, stratigrafia dhe mosha e shkëmbinjve që marrin pjesë në ndërtimin e rajonit dhe vendburimit.

2. Zhvillimi i tektonikave kryesore, tektonika e vendburimit.

3. Kushtet hidrogeologjike dhe rrjeti hidrografik i rajonit.

4. Kushtet hidrografike dhe hidrogeologjike të vendburimit.

5. Vendburimet dhe objektet e njohura.

6. Vendburimet e shfrytëzuara apo në shfrytëzim.

7. Rezervat e njohura sipas vendburimeve dhe objekteve, sasia dhe cilësia e tyre.

8. Mbi morfologjinë dhe përbërjen e xeherorit dhe/ose xeherorëve të dobishëm. Të dhëna të shkurtra mbi llojin e mineralit.

9. Vendndodhja e vendburimit dhe elementet topografike të saj.

10. Vendosja e trupit xeheror, shkëmbinjte e tavanit dhe dyshemesë.

11. Elementet gjeometrike të vendosjes në hapësirë të trupit dhe/ ose trupave xeherorë.

12. Lloji i kontaktit me shkëmbinjte rrethues.

13. Trashësia dhe lloji i mbulesës dhe elementet gjeometrike të tyre.

14. Vetitë fiziko-mekanike të shkëmbinjve.

15. Vetitë fiziko-mekanike të xeherorit të dobishëm.

16. Punimet e kryera (rilevime, kanale, puse, galeri, shpime, metoda gjeofizike etj., që kanë shërbyer për zbulimin e vendburimit, metoda e llogaritjes së rezervave dhe tabela e llogaritjes së rezervave.

17. Të dhëna mbi mineralizimin.

18. Të dhëna të shkurtra mbi mineralet që ndodhen në rajon, shoqëruar me hartën gjeologjike të saj në shkallë (1:10 000 – 1:50 000), historiku i studimeve dhe punimeve të kryera, rezultatet e tyre.

19. Mineralet e dobishme të zonës nga të dhënat arkivore, përshkrim më të plotë për mineralin apo mineralet për të cilët kërkohet leja.

20. Përbërja mineralogjike e trupit xeheror.

21. Përmbajtja e elementeve të dobishëm.

5. Mënyra e propozuar e shfrytëzimit dhe/ose përpunimit të mineraleve

a) Përshkrim i sistemit të shfrytëzimit që do të aplikohet.

b) Përshkrim i proceseve të seleksionimit, thyerjes, fraksionimit, pasurimit apo metodave të tjera që do të përdoren për përpunimin e mineralit dhe realizimin e produkteve të parashikuara, me skemat përkatëse teknologjike dhe treguesit.

6. Përshkrim i programit të shfrytëzimit dhe/ose përpunimit të mineraleve të propozuara
Miniera-Shfrytëzimi

6.1 Rezervat që merren parasysh në projektim, ndarë sipas horizonteve dhe profileve, shoqëruar me tabelën përkatëse

6.2 Kushtet tekniko-minerare të vendburimit

Parametrat e trupit, trupave ose zonës së mineralizuar:

- a) Shtrirja m;
- b) Trashësia m;
- c) Zhytja m (nga kuota + deri në kuotën +);
- d) Këndi i zhytjes gradë;
- e) Kondicioni;
- f) Sasia e ujërave nëntokësore m³/min ose l/sek.

6.3 Në rastet kur kemi të bëjmë me një shfrytëzim nëntokësor të vendburimit:

- 1. Hapja e minierës;
 - 2. Studimi dhe përshkrimi i varianteve të hapjes;
 - 3. Kapaciteti prodhues dhe jeta e minierës;
 - 4. Punimet kryesore të hapjes;
 - 5. Përcaktimi i lartësisë së katit;
 - 6. Grafiku i zhvillimit të punimeve jepet në tabelën e mëposhtme;
 - 7. Grafiku i prodhimit, paraqitur si në tabelën e mëposhtme;
 - 8. Depozitimi i sterilit dhe mineralit;
 - 9. Mekanizimi i proceseve të punës në nëntokë;
 - 10. Ajrimi i minierës;
 - 11. Furnizimi me ajër të ngjeshur;
 - 12. Shpimi i lagur në minierë;
 - 13. Largimi i ujërave nga miniera;
 - 14. Organizimi dhe fuqia punëtore dhe paga mesatare;
 - 15. Sigurimi teknik;
 - 16. Furnizimi me energji elektrike;
 - 17. Makineritë dhe pajisjet e minierës;
 - 18. Përshkrimi i objekteve sipërfaqësore dhe të nëntokës;
 - 19. Objektet përpunuese, përpunimi i mineralit;
 - 20. Përcaktimi i skemës/skemave teknologjike të trajtimit të xeherorit dhe zgjedhja e skemës optimale;
 - 21. Përcaktimi i skemës së pajisjeve;
 - 22. Projekti përkatës me përllogaritjet e pajisjeve, sasive të pulpave, koncentrimin të së ngurtës, sasisë së ujit etj.;
 - 23. Treguesit përfundimtarë të trajtimit të xeherorit;
 - 24. Tabela përmbledhëse e investimeve;
 - 25. Analiza ekonomike;
- do të përshkruhen si në përcaktimet e aneksit 2 të këtij urdhri.

6.4 Në rastet kur kemi të bëjmë me një shfrytëzim sipërfaqësor të vendburimit elementet e pikës 6.3 të këtij aneksi do të përshkruhen sipas aneksit 4 të këtij urdhri.

7. Përshkrim i infrastrukturës së nevojshme për realizimin e projektit të veprimtarive minerare

- a) Rrugë automjetesh për realizimin e punimeve të shfrytëzimit dhe përpunimit të mineralit;
- b) Sheshet e punimeve të shfrytëzimit, fabrikave të përpunimit të mineralit dhe depozitimit të mbetjeve;
- c) Ngritja e kantierit (zyra, pajisje orendi dhe ambiente të tjera, si: banjë, gardërobë, fjetore, mensë, magazinë materialesh, kabina elektrike, gjenerator, stacion pompimi, depoja e lëndës plasëse etj.).

8. Përcaktimi i vlerës së investimit

- a) Për punimet e programuara të jepet:
 - i) vëllimi i tyre;
 - ii) shpenzimet e programuara për secilin zë dhe në tërësi.
- b) Mbi bazën e kostove të operacioneve të kërkim-zbulim-shfrytëzimit dhe përpunimit për programin e investimit të bëhet vlerësimi i investimit total dhe përcaktimi i vlerës së garancisë financiare vjetore për realizimin e programit të investimit.

9. Të dhëna lidhur me punësimin dhe specializimin e shtetasve shqiptarë
10. Të dhëna mbi identifikimin e ndikimeve në mjedis gjatë hapjes së punimeve minerare
- a) Dëmtimi i sipërfaqes së tokës, erozioni gjatë hapjes dhe kryerjes së punimeve dhe masat për dëmtime të sipërfaqes së tokës nga operacionet e gërmimit;
- b) Dëmtimi i florës, faunës dhe bimët e ujit dhe masat parandaluese e rehabilituese;
- c) Shkarkimet e ujërave, pluhurat gjatë procesit të punës, zhurmat, emetimi i gazrave nga pajisjet, mjeteve motorike dhe makineritë, ndikimi në mjedis i produkteve të lëndëve plasëse dhe masat përkatëse;
- d) Prodhimi i mbeturinave dhe depozitimi i materialeve që krijohen gjatë hapjes dhe shfrytëzimit të objektit;
- e) Masat për rigjenerimin e peizazhit;
- f) Ndikimi në infrastrukturën e zonës së objektit dhe masat përkatëse;
- g) Ndikim në shëndetin e njerëzve që punojnë në objekt dhe në jetën e banorëve përreth, qarkullimin dhe transportin dhe masat përkatëse;
- h) Plani i monitorimit të mjedisit.
11. Përfundime dhe rekomandime
- B. Pjesa tabelore e projektit të veprimtarisë minerare të kërkim-zbulim-shfrytëzimit për kërkesat për leje minerare të kërkim-zbulim-shfrytëzimit për grupin e mineraleve të çmuara dhe gjysmë të çmuara do të përbëhet nga tabelat e mëposhtme:

a) Tabela përmbledhëse e investimeve dhe grafiku i kryerjes

| Nr. | Emërtimi i investimeve | Lekë | Fazat | | |
|-----|--|------|-------|----|-----|
| | | | I | II | III |
| 1 | Studim, projektim, vlerësim | | | | |
| 2 | Rrugë etj | | | | |
| 3 | Sheshe pune etj. | | | | |
| 4 | Ndërtim montime etj. | | | | |
| 5 | Objekte sipërfaqësore, zyra, ambiente punonjësish, pajisje, orendi | | | | |
| 6 | Puse, anekse | | | | |
| 7 | Punime minerare kapitale | | | | |
| 8 | Punime minerare të kërkim-zbulimit | | | | |
| 9 | Punime minerare të shfrytëzimit | | | | |
| 10 | Makineri, pajisje të sipërfaqes dhe nëntokës | | | | |
| 11 | Investime për përpunimin e mineralit | | | | |
| 12 | Investime për rehabilitimin minerar | | | | |
| 13 | Investim për menaxhimin e mbetjeve | | | | |
| |etj... | | | | |
| | Total i investimeve sipas fazave e viteve | | | | |
| | Periudha në vite e realizimit të investimit | | | | |
| | Vlera e garancisë financiare vjetore për realizimin e planit të investimit | | | | |

Shënim. Fazat të përcaktohen me vitet e jetëgjatësisë së lejes minerare.

b) Tabela e detajuar për zërat e investimeve për vitin e parë (e njëjta tabelë duhet të parashikohet për vitin e dytë dhe të tretë)

| Nr. | Emërtimi | Tremujori I | | Tremujori II | | Tremujori III | | Tremujori IV | |
|-----|---|-------------|------|--------------|------|---------------|------|--------------|------|
| | | Lekë | Sasi | Lekë | Sasi | Lekë | Sasi | Lekë | Sasi |
| 1.a | Studim | | | | | | | | |
| 1.b | Projektim | | | | | | | | |
| 1.c | Vlerësim | | | | | | | | |
| 2.a | Zyra, mjedise pune, pajisje orendi | | | | | | | | |
| 2.b | Ambiente për punonjësit, banjë, gardërobë, fjetore, mensë | | | | | | | | |
| 2.c | Magazinë materialesh, kabina elektrike, gjenerator | | | | | | | | |
| 2.d | Stacion pompimi, depoja e lëndës plasëse | | | | | | | | |
| 2.e | Etj. | | | | | | | | |
| 3.a | Mjete transporti | | | | | | | | |
| 3.b | Makineri, sonda etj. | | | | | | | | |

| | | | | | | | | | |
|-------|------------------------|--|--|--|--|--|--|--|--|
| 3.c | Pajisje | | | | | | | | |
| 3.d | Etj. | | | | | | | | |
| 4.a | Hapje rrugësh | | | | | | | | |
| 4.b | Hapje sheshesh | | | | | | | | |
| 5.a | Punime sipërfaqësore | | | | | | | | |
| 5.b | Punime nëntokësore | | | | | | | | |
| 5.c | Etj. | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | |
| |Etj. | | | | | | | | |
| | Investimi total | | | | | | | | |

c) Të dhëna për fuqinë punëtore

| Nr. | Emërtimi | Tremujori I | | Tremujori II | | Tremujori III | | Tremujori IV | |
|-----|---|-------------|------|--------------|------|---------------|------|--------------|------|
| | | Sasi | Lekë | Sasi | Lekë | Sasi | Lekë | Sasi | Lekë |
| 1 | Numri i personelit inxhiniero-teknik | | | | | | | | |
| 2 | Numri total i punonjësve | | | | | | | | |
| 3 | Pagesa e punonjësve | | | | | | | | |
| 4 | Pagesat për sigurimin e jetës | | | | | | | | |
| 5 | Pagesat për sigurimet shoqërore | | | | | | | | |
| | Totali i pagesave për punonjësit | | | | | | | | |

C. Pjesa grafike e projektit të zhvillimit të veprimtarisë minerare të kërkim-zbulim-shfrytëzimit për kërkesat për leje minerare të kërkim-zbulim-shfrytëzimit për grupin e mineraleve të çmuara dhe gjysmë të çmuara do të jetë sipas tabelës së mëposhtme:

| Nr | Emërtimi | Shkalla |
|----|--|--|
| | Për shfrytëzimin me minierë | |
| 1 | Harta topografike me zonën e kërkuar | 1:25000 |
| 2 | Harta topografike me zonën e kërkuar me dokumentimin e infrastrukturës së aktualizuar (e azhurnuar) | 1:5000 ose 1:2000, ose 1:1000, ose 1:500 |
| 3 | Harta gjeologo-topografike me punimet e kryera për kërkim-zbulimin e xeherorit (kanale, puse, galeri shpime) | 1:5000 ose 1:2000, ose 1:1000, ose 1:500 |
| 4 | Profilat gjatësore e tërthore gjeologo-topografike, sipas rrjetit të përcaktuar | 1:1000 ose 1:2000, ose 1:500 |
| 5 | Projeksioni vertikal me gjeometrizimin e trupit dhe/ose trupave apo zonës së mineralizuar | 1:1000 ose 1:2000, ose 1:500 |
| 6 | Profili gjeologo-topografik me zbulimin e shfrytëzimin në vite | 1:1000 |
| 7 | Prerja gjatësore, kategorizimi i rezervave gjeologjike | 1:1000 |
| 8 | Planimetria e përgjithshme e minierës me punimet e hapjes | 1:1000 ose 1:2000, ose 1:500 |
| 9 | Planimetria e çdo horizonti me punimet kryesore | 1:1000 ose 1:2000, ose 1:500 |
| 10 | Profilat kryesore me punimet e hapjes dhe përgatitje sipas horizonteve | 1:1000 ose 1:2000, ose 1:500 |
| 11 | Projeksioni vertikal me punimet e hapjes dhe përgatitjes sipas horizonteve | 1:1000 ose 1:2000, ose 1:500 |
| 12 | Harta topografike e sipërfaqes së minierës me rrugët, sistemimet, vendosjen e objekteve sipërfaqësore dhe sheshet e depozitimit të sterileve apo nënprodukteve, e projektuar | 1:5000 ose 1:2000, ose 1:1000, ose 1:500 |
| 13 | Planimetria e përgjithshme me rrugët e ajrimit dhe skema hapësinore e ajrimit | 1:100, 1:200, ose skematike me parametra |
| 14 | Skema e furnizimit me ajër të ngjeshur | |
| 15 | Skema e furnizimit me ujë për shpimin e lagur | |
| 16 | Skema e largimit të ujërave | |
| 17 | Skema e shpërndarjes së rrjetit të furnizimit me energji elektrike | |
| 18 | Pasaporta e sistemit të shfrytëzimit, dhe pasaportat e shpim-plasjes së armatimit të punimeve minerare | |
| 19 | Seksione të punimeve të hapjes dhe armatimi i tyre | 1:25 |
| 20 | Skema të ajrimit të punimeve të veçanta (sipas rastit) | |
| 21 | Harta topografike e vendburimit me konturet e zonave të rrezikshme nga influenza e shfrytëzimit | 1:1.000, 1:2.000 |
| 22 | Skema e vendosjes së makinerive e pajisjeve nëntokë dhe sipërfaqe | |
| | Objektet e përpunimit të mineralit | |
| 23 | Impianti i përpunimit | 1:25.000 |
| 24 | Planimetria e përgjithshme e impiantit të përpunimit | 1:500 |
| 25 | Skema e vendosjes së makinerive dhe pajisjeve në objektin e përpunimit të xeherorit | 1:50, 1:100, 1:200 |
| 26 | Skema e trajtimit të produkteve, ujërave, pluhurit dhe mbetjeve | 1:1.000, 1:2.000 |

| | | |
|-------------------------------------|--|--|
| 27 | Skema e rehabilitimit mjedisor | 1:1.000, 1:2.000 |
| 28 | Skema e monitorimit | 1:1.000, 1:2.000 |
| 29 | Skema e veprimit në rast shkarkimesh aksidentale | 1:1.000, 1:2.000 |
| Për shfrytëzimin me karrierë | | |
| 1 | Harta topografike me zonën e kërkuar | 1:25000 |
| 2 | Harta topografike me zonën e kërkuar me dokumentimin e infrastrukturës së aktualizuar (e azhurnuar) | 1:5000 ose 1:2000, ose 1:1000, ose 1:500 |
| 3 | Harta gjeologo-topografike me punimet e kryera për kërkim-zbulimin e xeherorit (kanale, puse, galeri shpime) | 1:5000 ose 1:2000, ose 1:1000 ose 1:500 |
| 4 | Profilet gjatësore e tërthore gjeologo-topografike, sipas rrjetit të përcaktuar | 1:1000 ose 1:2000, ose 1:500 |
| 5 | Projeksioni vertikal me gjeometrizimin e trupit dhe/ose trupave apo zonës së mineralizuar | 1:1000 ose 1:2000, ose 1:500 |
| 6 | Profili gjeologo-topografik me zbulimin e shfrytëzimin në vite | 1:1000 |
| 7 | Prerja gjatësore, kategorizimi i rezervave gjeologjike | 1:1000 |
| 8 | Planimetria e përgjithshme e karrierës me punimet e hapjes | 1:1000 ose 1:2000, ose 1:500 |
| 9 | Planimetria e gjendjes përfundimtare të karrierës, punimet e projektuara, vendosjen e objekteve sipërfaqësore dhe sheshet e depozitimit të mineralit sterileve dhe nënprodukteve | 1:1000 ose 1:500 |
| 10 | Skema e furnizimit me ujë | |
| 11 | Skema e largimit të ujërave | |
| 12 | Skema e shpërndarjes së rrjetit të furnizimit me energji elektrike | |
| 13 | Pasaporta e sistemit të shfrytëzimit, dhe pasaportat e shpim-plasjes në karrierë | |
| 14 | Skemat e sheshit të punës | |
| 15 | Harta topografike me kufijtë e zonës së rrezikshme nga punimet me L.P. në karrierë | 1:1.000, 1:2.000 |
| 16 | Harta topografike e vendburimit me konturet e zonave të rrezikshme nga influenca e shfrytëzimit | 1:1.000, 1:2.000 |
| 17 | Skema e vendosjes së makinerive e pajisjeve të shfrytëzimit | |
| | Objektet e përpunimit të mineralit | |
| 18 | Impianti i përpunimit | 1:25.000 |
| 19 | Planimetria e përgjithshme e impiantit të përpunimit | 1:500 |
| 20 | Skema e vendosjes së makinerive dhe pajisjeve në objektin e përpunimit të xeherorit | 1:50, 1:100, 1:200 |
| 21 | Skema e trajtimit të produkteve, ujërave, pluhurit dhe mbetjeve | 1:1.000, 1:2.000 |
| 22 | Skema e rehabilitimit mjedisor | 1:1.000, 1:2.000 |
| 23 | Skema e monitorimit | 1:1.000, 1:2.000 |
| 24 | Skema e veprimit në rast shkarkimesh aksidentale | 1:1.000, 1:2.000 |

ANEKSI 6

1. Forma dhe përmbajtja projektit të zhvillimit të veprimtarisë minerare për kërkesat për leje minerare të kërkim-zbulimit për grupin e mineraleve radioaktive do të jetë në përputhje me kërkesat e aneksit 3 të këtij urdhri.

2. Forma dhe përmbajtja projektit të zhvillimit të veprimtarisë minerare për kërkesat për leje minerare të shfrytëzimit për grupin e mineraleve radioaktive do të jetë në përputhje me kërkesat e aneksit 4 të këtij urdhri.

3. Për aktivitetet minerare të kërkim-zbulimit, shfrytëzimit dhe përpunimit të mineraleve radioaktive duhet të respektohen të gjitha kërkesat e planit të depozitimit të mbetjeve minerare dhe planit të mbrojtjes nga aksidentet sipas përcaktimeve të ligjit nr.10 304, datë 15.7.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë” dhe shkarkimeve të përcaktuara në legjislacionin mjedisor.

URDHËR
Nr.305, datë 13.4.2011

**PËR PROCEDURAT DHE FORMËN E HARTIMIT TË PROGRAMIT TË VEPRIMIT PËR
ZBATIMIN E STRATEGJISË MINERARE**

Në zbatim të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 8 pika 7 dhe nenit 56 pika 2 të ligjit nr.10 304, datë 15.7.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”,

URDHËROJ:

1. Programi i veprimit për zbatimin e strategjisë minerare është dokumenti afatmesëm i planifikimit minerar, që hartohet në bazë të strategjisë minerare dhe është i vlefshëm për një periudhë 3-vjeçare. Programi i veprimit duhet të përmbajë:

- a) drejtimet për zhvillimin e sektorit minerar;
- b) promovimin e zonave minerare, për të cilat do të jepen lejet minerare, përmes procesit të konkurrimit apo procedurave të hapura mbështetur në hartën minerare digjitale;
- c) programimin e veprimtarive të kërkimeve themelore gjeologjike;
- d) parashikimin e përgjithshëm të produktit vjetor në sektorin minerar;
- e) nevojat për zhvillimin e burimeve njerëzore, profesionale, në veprimtaritë minerare,
- f) zonat e rrezikshme, ku veprimtaria minerare është e ndaluar dhe ku ndalohet dhënia e të drejtave minerare;
- g) zonat minerare perspektive.

2. Programi i veprimit për zbatimin e strategjisë minerare duhet të realizohet mbi bazën e informacionit gjeologo-minerar, dhe në përputhje me drejtimet e zhvillimit të sektorit minerar, të përcaktuara në strategjinë minerare të Republikës së Shqipërisë.

3. Programi i veprimit për zbatimin e strategjisë minerare hartohet për një periudhë 3-vjeçare (tre).

4. Programi i veprimit për zbatimin e strategjisë minerare hartohet nga institucionet e Shërbimit Gjeologjik Shqiptar (SHGJSH) dhe Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN) mbi bazën e informacioneve ekzistuese dhe studimeve përgjithësuese që realizojnë këto struktura përgjegjëse.

5. Institucionet e SHGJSH-së dhe AKBN-së duhet të përfundojnë hartimin e programit të veprimit për zbatimin e strategjisë minerare dhe ta paraqesin për shqyrtim në drejtorinë përgjegjëse për veprimtarinë minerare të Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (METE) jo më vonë se 120 (njëqind e njëzet) ditë kalendarike përpara përfundimit të vitit kalendarik që korrespondon me përfundimin e programit të veprimit për zbatimin e strategjisë minerare të mëparshme.

6. Institucioni i SHGJSH-së në programin e veprimit për zbatimin e strategjisë minerare përcakton:

a) Zonat minerare të përcaktuara sipas hartës gjeologjike pa informacion gjeologjik të mjaftueshëm ku dhënia e të drejtave minerare do të zhvillohet sipas procedurave të zonave të hapura;

b) Zonat minerare të përcaktuara sipas hartës gjeologjike, ku sipas informacionit gjeologjik kemi të bëjmë me minerale të grupit të mineraleve metalore, jometalore, qymyret dhe bitumet dhe grupit të mineraleve radioaktive, ku dhënia e të drejtave minerare do të zhvillohet sipas procedurave konkurruese.

c) Zonat minerare, për të cilat kanë informacionin e nevojshëm gjeologjik për të zhvilluar veprimtari minerare shfrytëzimi bazuar në informacionet ekzistuese dhe studimet përgjithësuese të realizuara ku dhënia e të drejtave minerare do të zhvillohet sipas procedurave konkurruese.

d) Zonat minerare, për të cilat është realizuar kërkim-zbulimi nga subjektet minerare dhe që nuk janë shndërruar nga këto subjekte në zona minerare shfrytëzimi, dhe SHGJSH-ja ka informacion të mjaftueshëm dhe i vlerëson si zona për të zhvilluar veprimtari minerare shfrytëzimi, ku dhënia e të drejtave minerare do të zhvillohet sipas procedurave konkurruese.

e) Zonat minerare të rrezikshme nga ana gjeologjike, në të cilat veprimtaria minerare mund të ndikojë në jetën e komunitetit dhe ku duhet të ndalohet dhënia e të drejtave minerare;

f) Zonat minerare perspektive për zhvillimin e veprimtarive minerare.

7. Institucioni i AKBN në programin e veprimit për zbatimin e strategjisë minerare përcakton:
- Zonat minerare, për të cilat kanë informacionin e nevojshëm minerar për të zhvilluar veprimtari minerare shfrytëzimi, të cilat mendohen të promovohen gjatë periudhës trevjeçare dhe ku dhënia e të drejtave minerare do të zhvillohet sipas procedurave konkurruese.
 - Zonat minerare të braktisura nga ana e subjekteve minerare, të konservuara, mbyllura, ose prona të vjetra minerare të braktisura të ish-ndërmarrjeve shtetërore, për të cilat kanë informacionin e nevojshëm minerar për të zhvilluar veprimtari minerare shfrytëzimi dhe mund të rezultojnë me interes publik për shfrytëzim ku dhënia e të drejtave minerare do të zhvillohet sipas procedurave konkurruese.
 - Zonat minerare të rrezikshme, në të cilat ndalohet kryerja e veprimtarive minerare dhe dhënia e të drejtave minerare;
 - Zonat minerare perspektive për zhvillimin e veprimtarive minerare.
8. Format i programit të veprimit për zbatimin e strategjisë minerare përcaktohet në aneksin nr.1, bashkangjitur këtij urdhri.
9. Drejtoria përgjegjëse në METE për veprimtarinë minerare realizon të gjitha procedurat e marrjes së mendimit për këtë program nga ministritë përgjegjëse për mjedisin, pyjet, tokën bujqësore, trashëgiminë kulturore, turizmin e mbrojtjen dhe njësitë e qeverisjes vendore përkatëse. Procedura e marrjes së opinionit nga njësitë e qeverisjes vendore përkatëse realizohet nëpërmjet institucionit të prefektit, mendim, i cili duhet të përmbajë opinionin e njërive të qeverisjes vendore, të shprehur nëpërmjet vendimit të këshillit të njësisë së qeverisjes vendore. Mendimet e Ministrive dhe mendimi i prefektit që duhet të këtë të bashkangjitur dhe vendimet e këshillave të njërive të qeverisjes vendore të qarkut duhet të dorëzohen në METE brenda një afati prej 60 (gjashtëdhjetë) ditësh kalendarike. Tejkalimi i këtij afati vlerësohet si miratim në heshtje i propozimit për zonat minerare të qarkut përkatës.
10. Drejtoria përgjegjëse në METE për veprimtarinë minerare realizon të gjitha procedurat e miratimit të Programit të veprimit për zbatimin e strategjisë minerare nga Këshilli i Ministrave.
11. Programi i veprimit për zbatimin e strategjisë minerare pas miratimit publikohet në faqen e internetit të METE-s, në Fletoren Zyrtare dhe pasqyrohet në hartën minerare digjitale jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë kalendarike përpara përfundimit të vitit kalendarik që korrespondon me përfundimin e programit të veprimit për zbatimin e strategjisë minerare të mëparshme.
12. Çdo ndryshim apo shtesë në programin e veprimit për zbatimin e strategjisë minerare miratohen dhe publikohen sipas së njëjtës procedurë.
13. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet institucioni i SHGJSH-së, AKBN-së dhe drejtoria përgjegjëse në METE, që trajton veprimtarinë minerare.
- Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë

**MINISTRI I EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS
NASIP NAÇO**

**ANEKSI 1
FORMATI I HARTIMIT TË PROGRAMIT TË VEPRIMIT PËR ZBATIMIN E STRATEGJISË
MINERARE**

- Zonat minerare të planifikuara për veprimtari minerare në programin e veprimit për zbatimin e strategjisë minerare duhet të jenë të ndara në zona të hapura dhe zona konkurruese. Harta e zonave duhet të jetë digjitale.
- Sipërfaqja e zonave minerare të përcaktuara në programin e veprimit për zbatimin e strategjisë minerare duhet të jepet e kufizuar nga pikat me koordinatat respektive në plan, të dhëna në tabelë dhe të hedhura në GIS.
- Për çdo zonë minerare, për të cilën të drejtat minerare do të jepen sipas procedurave për zonat e hapura duhet të përcaktohen:
 - Emërtimi i zonës minerare me numër rendor;
 - Emrin e njësisë/njësive së qeverisjes vendore dhe qarkut/qarqeve, në të cilin ndodhet zona minerare;
 - Sipërfaqja e zonës së lejuar minerare;
 - Lloji i mineralit/mineraleve që ndodhen në zonë;

e) Lloji i veprimtarisë minerare, që propozohet të realizohet në zonën minerare të kërkim-zbulim-shfrytëzimit.

4. Për çdo zonë minerare, për të cilën të drejtat minerare do të jepen sipas procedurave konkurruese duhet të përcaktohen:

- a) Emërtimi i zonës minerare me numër rendor;
- b) Emërtimi i vendburimit/vendburimeve të mineralit që përfshihen në zonën minerare;
- c) Emrin e njësisë/njësive së qeverisjes vendore dhe qarkut/qarqeve, në të cilin ndodhet zona minerare;
- d) Sipërfaqja e zonës së lejuar minerare;
- e) Lloji i mineralit/mineraleve që ndodhen në zonë;
- f) Një informacion të përmbledhur gjeologjik të vendburimit/vendburimeve;
- g) Kapaciteti i njohur i rezervave të zonës minerare;
- h) Cilësia e mineralit/mineraleve të dobishme;
- i) Lloji i veprimtarisë minerare që propozohet të realizohet në zonën minerare të kërkim-zbulim-shfrytëzimit.

URDHËR
Nr.306, datë 13.4.2011

PËR PROCEDURAT DHE FORMËN E HARTIMIT TË PLANIT VJETOR MINERAR

Në zbatim të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe të nenit 8 pika 6 dhe nenit 56 pika 2 të ligjit nr.10 304, datë 15.7.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”,

URDHËROJ:

1. Plani vjetor minerar duhet të realizohet mbi bazën e informacionit gjeologo-minerar, dhe në përputhje me drejtimit e zhvillimit të sektorit minerar, të përcaktuara në programin e veprimit të strategjisë minerare për periudhën 3-vjeçare (tre).

2. Plani vjetor minerar është kalendarik.

3. Plani vjetor minerar hartohet nga institucionet e Shërbimit Gjeologjik Shqiptar (SHGJSH) dhe Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN) mbi bazën e informacioneve ekzistuese dhe studimeve përgjithësuese që realizojnë këto struktura përgjegjëse.

4. Institucionet e SHGJSH-së dhe AKBN-së duhet të përfundojnë hartimin e planit vjetor minerar dhe ta paraqesin për shqyrtim në drejtorinë përgjegjëse për veprimtarinë minerare të Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (METE) jo më vonë se 70 (shtatëdhjetë) ditë kalendarike përpara përfundimit të vitit kalendarik.

5. Institucioni i SHGJSH-së në planin vjetor minerar përcakton:

a) Zonat minerare të përcaktuara sipas hartës gjeologjike pa informacion gjeologjik të mjaftueshëm, për të cilat kërkohet një veprimtari kërkim-zbulimi. Në këto zona dhënia e të drejtave minerare do të zhvillohet sipas procedurave të zonave të hapura;

b) Zonat minerare pa informacion gjeologjik të mjaftueshëm për realizimin e një veprimtarie minerare shfrytëzimi, ku sipas informacionit paraparak kemi të bëjmë me minerale të grupit të mineraleve metalore, jometalore, qymyret dhe bitumet dhe të grupit të mineraleve radioaktive, për të cilat kërkohet një veprimtari kërkim-zbulimi. Në këto zona dhënia e të drejtave minerare do të zhvillohet sipas procedurave konkurruese, SHGJSH-ja duhet të përcaktojë kriteret e konkurrimit;

c) Zonat minerare për të cilat kanë informacionin e nevojshëm gjeologjik për të zhvilluar veprimtari minerare shfrytëzimi bazuar në informacionet ekzistuese dhe studimet përgjithësuese të realizuara. Në këto zona dhënia e të drejtave minerare do të zhvillohet sipas procedurave konkurruese, SHGJSH-ja duhet të përcaktojë kriteret e konkurrimit;

d) Zonat minerare për të cilat është realizuar kërkim-zbulimi nga subjektet minerare dhe që nuk janë shndërruar nga këto subjekte në zona minerare shfrytëzimi, kanë informacionin e nevojshëm gjeologjik për të zhvilluar veprimtari minerare shfrytëzimi. Në këto zona dhënia e të drejtave minerare do të zhvillohet sipas procedurave konkurruese, SHGJSH-ja duhet të përcaktojë kriteret e konkurrimit;

e) Zonat minerare të rrezikshme nga ana gjeologjike në të cilat veprimtaria minerare mund të ndikojë në jetën e komunitetit dhe ku duhet të ndalohet dhënia e të drejtave minerare;

f) Zonat minerare perspektive për zhvillimin e veprimtarive minerare.

6. Institucioni i AKBN-së në planin vjetor minerar përcakton:

a) Zonat minerare për të cilat kanë informacionin e nevojshëm minerar për të zhvilluar veprimtari minerare shfrytëzimi bazuar në informacionet ekzistuese dhe studimet përgjithësuese të realizuara, të cilat mendohen të promovohen atë vit për zhvillimin e veprimtarive minerare. Në këto zona dhënia e të drejtave minerare do të zhvillohet sipas procedurave konkurruese, AKBN-ja duhet të përcaktojë kriteret e konkurrimit;

b) Zonat minerare të braktisura nga ana e subjekteve minerare, në të cilat nuk janë nxjerrë të gjitha rezervat minerare dhe vlerësohen për zhvillim të një veprimtarie minerare shfrytëzimi. Në këto zona dhënia e të drejtave minerare do të zhvillohet sipas procedurave konkurruese, AKBN-ja duhet të përcaktojë kriteret e konkurrimit;

c) Zonat minerare të konservuara, mbyllura, ose prona të vjetra minerare të braktisura të ish-ndërmarrjeve shtetërore për të cilat kanë informacionin e nevojshëm minerar për të zhvilluar veprimtari minerare shfrytëzimi dhe mund të rezultojnë me interes publik për shfrytëzim. Në këto zona dhënia e të drejtave minerare do të zhvillohet sipas procedurave konkurruese, AKBN-ja duhet të përcaktojë kriteret e konkurrimit;

d) Zonat minerare që kërkohen të transferohen, për të cilat dhënia e të drejtave minerare është realizuar sipas procedurave konkurruese. Në këto zona dhënia e të drejtave minerare do të zhvillohet sipas procedurave konkurruese, AKBN-ja duhet të përcaktojë kriteret e konkurrimit;

e) Zonat minerare të rrezikshme në të cilat ndalohet kryerja e veprimtarive minerare dhe dhënia e të drejtave minerare;

f) Zonat minerare perspektive për zhvillimin e veprimtarive minerare.

7. Format i planit vjetor minerar përcaktohet në aneksin nr.1, bashkangjitur këtij urdhri.

8. Drejtoria përgjegjëse në METE për veprimtarinë minerare realizon të gjitha procedurat e këshillimit të këtij plani me ministritë përgjegjëse për mjedisin, pyjet, tokën bujqësore, trashëgiminë kulturore, turizmin e mbrojtjen dhe njësitë e qeverisjes vendore përkatëse. Procedura e marrjes së opinionit nga njësitë e qeverisjes vendore përkatëse realizohet nëpërmjet institucionit të prefektit, mendim, i cili duhet të përmbajë opinionin e njësisë të qeverisjes vendore të shprehur nëpërmjet vendimit të këshillit të njësisë së qeverisjes vendore. Mendimet e ministrive dhe mendimi i prefektit që duhet të këtë të bashkangjitur dhe vendimet e këshillave të njësisë të qeverisjes vendore të qarkut duhet të dorëzohen në METE brenda një afati prej 30 (tridhjetë) ditësh kalendarike. Tejkalimi i këtij afati vlerësohet si miratim në heshtje i propozimit për zonat minerare të qarkut përkatës.

9. Drejtoria përgjegjëse në METE për veprimtarinë minerare realizon të gjitha procedurat e miratimit të planit vjetor minerar nga Ministri.

10. Plani vjetor minerar pas miratimit publikohet në faqen e internetit të METE-s, në Fletoren Zyrtare dhe pasqyrohet në hartën minerare digjitale jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë kalendarike përpara përfundimit të vitit kalendarik.

11. Çdo ndryshim apo shtesë në planin vjetor minerar miratohen dhe publikohen sipas së njëjtës procedurë.

12. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet institucioni i SHGJSH-së, AKBN-së dhe drejtoria përgjegjëse në METE që trajton veprimtarinë minerare.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS
NASIP NAÇO

ANEKSI 1
FORMATI I HARTIMIT TË PLANIT VJETOR MINERAR

1. Zonat minerare të planifikuara për veprimtari minerare në planin vjetor minerar duhet të jenë të ndara në zona të hapura dhe zona konkurruese. Harta e zonave duhet të jetë digjitale.

2. Sipërfaqja e zonave minerare të përcaktuara në planin vjetor minerar duhet të jepet e kufizuar nga pikat me koordinatat respektive në plan, të dhëna në tabelë dhe të hedhura në GIS.

3. Për çdo zonë minerare për të cilën të drejtat minerare do të jepen sipas procedurave për zonat e hapura duhet të përcaktohen:

- a) Emërtimi i zonës minerare me numër rendor;
- b) Emërtimi i vendburimit/vendburimeve të mineralit që përfshihen në zonën minerare;
- c) Emrin e njësisë/njësive së qeverisjes vendore dhe qarkut/qarqeve në të cilin ndodhet zona minerare;
- d) Sipërfaqja e zonës së lejuar minerare;
- e) Lloji i mineralit/mineraleve që ndodhen në zonë;
- f) Vlera e investimit që parashikohet të realizohet në zonën minerare;
- g) Kërkesat teknike dhe profesionale që duhet të plotësojë kërkuesi i lejes për marrjen e të drejtave minerare në atë zonë minerare;

4. Për çdo zonë minerare, për të cilën të drejtat minerare do të jepen sipas procedurave konkurruese, duhet të përcaktohen:

- a) Emërtimi i zonës minerare me numër rendor;
- b) Emërtimi i vendburimit/vendburimeve të mineralit që përfshihen në zonën minerare;
- c) Emrin e njësisë/njësive së qeverisjes vendore dhe qarkut/qarqeve, në të cilin ndodhet zona minerare;
- d) Sipërfaqja e zonës së lejuar minerare;
- e) Lloji i mineralit/mineraleve që ndodhen në zonë;
- f) Një informacion të përmbledhur gjeologjik të vendburimit/vendburimeve;
- g) Kapaciteti i rezervave të zonës minerare;
- h) Cilësia e mineralit/mineraleve të dobishme;
- i) Leverdia ekonomike për zhvillimin e veprimtarisë minerare;
- j) Lloji i veprimtarisë minerare që propozohet të realizohet në zonën minerare të kërkim-zbulim-shfrytëzimit;
- k) Vlera e investimit që parashikohet të realizohet në zonën minerare;
- l) Kërkesat teknike dhe profesionale që duhet të plotësojë kërkuesi i lejes për marrjen e të drejtave minerare në atë zonë minerare.

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.
Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2011, është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

| | |
|---|----------|
| KODI CIVIL | 360 lekë |
| KODI I FAMILJES | 310 lekë |
| KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE | 90 lekë |
| KODI PENAL USHTARAK | 55 lekë |
| KODI I PUNËS | 140 lekë |
| KANONI I ZHURISË | 40 lekë |
| PËRMBLEDHJE E VENDIMEVE TË GJYKATËS EUROPIANE | 328 lekë |
| PËR TË DREJTAT E NJERIUT KUNDËR SHQIPËRISË | |
| PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE | 140 lekë |
| PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË | 512 lekë |

Hyri në shtyp më 23.5.2011
Doli nga shtypi më 25.5.2011

Tirazhi: 1700 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2011

Çmimi 40 lekë